

Fëmija i kopshtit (parashkollor, 4-6 vjeç)

Fëmijët vijnë nga ambiente të ndryshme familjare dhe kulturore dhe kanë eksperiencë dhe personalitete të ndryshme. Megjithatë, fëmijët e kësaj moshe kanë disa karakteristika të përbashkëta.

Mësoj rreth
fëmijës


Nga ana e lëvizshmërisë/shkathëtisë:

- Mund të tregojnë lëvizshmëri dhe energji të theksuar për një kohë të shkurtër dhe të qetësohen për një kohë më të gjatë.
- Ngadalë-ngadalë muskujt e tyre forcohen dhe fëmijët kontrollojnë më mirë duart dhe këmbët e tyre.
- Fitojnë sensin e ritmit dhe u pëlqejnë të rrahin duart me ritmin e muzikës, të ecin me hapa të mëdhenj e të hapur ose të hidhen përpjetë e pupthi.
- Ende nuk kontrollojnë shumë mirë kombinimin sy-dorë.
- Mësojnë të fërshëllejnë dhe të shkelin syrin.

Nga ana shoqërore dhe ndjesore fëmijët e kësaj moshe mund:

- Të kenë fantazi të pasur dhe krijuese.
- Të preferojnë rezultatet e drejtpërdrejta dhe jo objektivat apo premtimet e largëta.
- Të vështirësohen të kuptojnë dhe të mbajnë mend rregullat (për këtë nevojitet t'ua rikujtosh shpesh).
- Të ndërrojnë shpesh mendje.
- Të jenë shumë kuriozë dhe e tregojnë duke bërë pyetje apo duke tentuar të bëjnë vetë gjëra të ndryshme.
- Të kenë dëshirë të marrim pjesë në aktivitetet e të të rriturve (p.sh. gatim, ustallëk, etj.).
- Të bashkëpunojnë me fëmijë të tjerë, por edhe të zihen shpesh.
- Të vonojnë të përfundojnë «punët» apo detyrat që kanë marrë përsipër, në veçanti nëse ua kanë vënë të rriturit.





Nga ana gjuhësore mund të vini re se u pëlqejnë:

- Të flasin dhe të tregojnë historitë e tyre.
- Të mësojnë fjalë të reja (p.sh. emrat e dinosaurëve!).
- Të bëjnë shaka.
- Të ndërtojnë fjalë të tyre dhe të qeshin me to.
- Të bëjnë shumë pyetje.
- Të «shkruajnë» me çdo mënyrë munden (gërma, figura, “simbole” të tyre).
- Të luajnë lojra në të cilat duhet të mendohen e të gjejnë përgjigjen p.sh të një enigme.
- Të shfletojnë një përrallë apo një histori dhe të bëjnë sikur lexojnë.

Gjithashtu fëmijët e kësaj moshe duket se:

- Dëshirojnë të ndjekin një program fiks («rutinë») gjatë ditës.
- Preferojnë të luajnë të lirë për një kohë të gjatë.
- Duan të ndiejnë ngrohtësinë e njerëzve të tyre.
- Duan të hanë, të vishen dhe të shkojnë në shkollë vetë.
- Kanë nevojë miratimet dhe lavdërimet e të të rriturve.
- Nevojiten caqe logjike dhe rregulla të drejta që të zbatohen qëndrueshëm dhe me dashuri.



Enti zbatues

POLIDHROMOS: Grupi dhe Botimi periodik për Dygjuhësinë dhe Shumëkulturën në Arsim dhe në Shoqëri



www.polydromo.gr
polydromo@polydromo.gr

Koordinatorë të programit

Birbili Maria – Cokalidhu Rula

Departamenti i Shkencave të Edukimit
dhe të Arsimit Parashkollor, Universiteti Aristoteli
Selanik

Email: mmpirmpi@nured.auth.gr

tsokalid@nured.auth.gr

Website: www.polydromo.gr/dialogos

Përkthyes

Valbona Hystuna

Përpunuan tekstin

Evi Marku

Me mbështetjen e

